**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR TIRANË**
**KËSHILLI I GJYKATËS**

Nr. 4814/1 prot. Tiranë më 16.12.2022

**VENDIM**

**Nr. 153/1, datë 16.12.2022**

**"MBI NDËRPRERJEN E SHORTIT PËR MUAJIN DHJETOR 2022"**

Në mbështetje të Ligjit nr. 98, datë 06.10.2016 "Për Organizimin e Pushtetit Gjyqësor në Republikën e Shqipërisë", nenit 27 dhe 37, në të cilin parashikohen kompetencat e Kryetarit të Gjykatës dhe Zëvendëskryetarit, si dhe nenin 23 të Ligjit nr. 96, datë 06.10.2016 "Për Statusin e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", Këshilli,

**KONSTATON**

Me qëllim mirë organizimin dhe menaxhimin e punës në Gjykatën e Rrethi Gjyqësor Tiranë, si dhe duke qenë se në fund të vitit kalendarik kryhen mbartjet e çështjeve në sistemin e menaxhimit elektronik;

**VENDOSI**

I. Ndërprerjen e hedhjes së shortit elektronik civil dhe penal për periudhën **23 12.2022** deri në datën **16.01.2023**, për shkak të mbartjeve të çështjeve për vitin 2022. Shorti për vitin 2023 do të fillojë më datën **16.01.2023**.

II. Për kërkesat civile, familjare dhe penale me karakter urgjent, shorti do të hidhet deri në datë **30.12.2022**.

III. Për periudhën 04.01.2023 deri në datën 16.01.2023, kërkesat civile, familjare dhe penale me karakter urgjent do t'i nënshtrohen shortit manual.

IV. Vendimi t'i njoftohet për zbatim trupës gjyqësore të Dhomës Civile dhe Penale, dhe kryesekretarive përkatëse.

V. Urdhërohet botimi i këtij vendimi në faqen zyrtare web të gjykatës.

VI. Urdhërohen kryesekretaritë përkatëse dhe Kancelari për zbatimin e këtij vendimi.

VII. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI I KËSHILLIT**

**FLAMUR KAPLLANI**

**ANËTARE**

**OLTJONA GOXHA**

**ANËTAR**

**DONALD XHELILI**